



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal/Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave/Ministry of Local Government Administration

DEPARTAMENTI LIGJOR/ ZAKONODAVNI DEPTAMENT/LEGAL DEPARTMENT

R A P O R T

Për zbatimin e legjislacionit primar nga fushëveprimi i MAPL-së

janar, 2009

H y r j e

Një ndër sprovat kryesore për Institucionet kompetente dhe përgjegjëse të cilat merren me krijimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit është zbatimi i drejt dhe efikas i ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës apo edhe i burimeve tjera të legjislacionit të cilat janë të aplikueshme për vendin tonë.

Krahasuar me hartimin dhe ndërtimin e infrastrukturës ligjore, zbatimi i ligjeve dhe i akteve tjera ligjore ka një ngecje të konsiderueshme për shkak të shumë faktorëve të cilat janë të rëndësishme së veçantë për zbatimin e legjislacionit. Vështirësitë në zbatimin e ligjeve mund t'i veshën pjesërisht prioritetit që institucionet përkatëse i kanë kushtuar hartimit të legjislacionit primar. Andaj kjo qasje në të ardhmen duhet të balancohet më mirë.

Është vlerësim i përgjithshëm se shumica e institucioneve vazhdojnë të kenë suksese të konsiderueshme në hartimin dhe krijimin e ligjeve të reja, në anën tjetër ende ka shumë vend dhe hapësirë për përmirësime, nëpër të gjitha Ministrinë e Ekzekutivit të vendit si dhe Komunitet, kur është në pyetje zbatimi i drejt dhe efikas i legjislacionit. Ngecjet në zbatimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe akteve tjera ligjore janë rezultat i shumë faktorëve. Me këtë rast do të veçojmë disa prej tyre:

- Në të gjitha Institucionet, të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit, prioritet absolut i është dhënë hartimit të ligjeve, e jo edhe zbatimit të tyre, pra ekziston një disproporcion i theksuar midis hartimit dhe zbatimit të Ligjeve .
- Kufizimet buxhetore, në të shumtën e rasteve janë shkas kryesor i pamundësisë së zbatimit të ligjeve në mënyrë të drejt dhe efikase.
- Mungesa e personelit profesional apo kapaciteteve administrative në Qeverisjen Lokale, njësitë tjera përkatëse apo strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit .
- Informimi jo i duhur i publikut, veçmas i grupeve të caktuara të interesit për përmbajtjen e akteve ligjore, ku janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet për ta;
- Mosekzistimi i një akti ligjor apo nënligjor i cili do të rregullonte dhe përcaktonte rregullat e zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës;
- Si dhe shumë faktorë tjerë të natyrës objektive dhe subjektive, të cilët drejtpërsëdrejti apo tërthorazi ndikojnë në zbatimin jo të plotë dhe joefikas të Ligjeve

Raport për zbatimin e Ligjeve nga Fushëveprimi i MAPL-së

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishtëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
1.	Ligji Për Vetëqeverisje Lokale	Nr. 03/L-040	20.02.2008	(a) i plotë	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/8 Për marrëveshjet e bashkëpunimit te komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane; - Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/9 Për transparencë në komuna; - Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/10 Për organizimin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në komuna; - Udhëzimi Administrativ 2009/1 për Procedurën e zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës; - Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2008 Për Pagesën e stafit politik në komuna (Qeverisë) 	

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishtëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
2.	Ligji për Barazi Gjinore	Nr. 3004/02	19 shkurt 2004	(a) i plotë	- Udhëzim Administrativ Nr. 2005/08 Për caktimin e kompetencave dhe përshkrimin e detyrave të punës së zyrtarëve për barazi gjinore në komuna	
3.	Ligji Për Përdorimin e Gjuhëve	Nr. 02/L-37	27.07.2006	(b) i plotë	- Udhëzim Administrativ Nr. 2007/2 Për përcaktimin e procedurave për zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve	

Raport për zbatimin e Ligjeve nga Fushëveprimi i Qeverisjes Lokale - Komunave

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
1.	Ligji Për Vetëqeverisje Lokale	Nr. 03/L-040	20.02.2008	(b) i pjesërishëm	<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i Statutit të Komunës (28 komuna); 2. Miratimi i Rregullores së Punës; 3. Miratimi i rregullores për bashkëpunim të komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane; 4. Miratimi i Rregullores komunale për transparencë 	
2.	Ligji për Barazi Gjinore	Nr. 3004/02	19 shkurt 2004	(a) i plotë	<ol style="list-style-type: none"> 5. Hartimi i politikave për promovimin e barazisë gjinore në komuna. 	

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
3.	Ligji Për Përdorimin e Gjuhëve	Nr. 02/L-37	27.07.2006	(b) i pjesërishëm	6. Miratimi i Rregullores lokale për përdorimin e gjuhëve në komuna	
4.	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal	Nr. 03/L-049	13.03.2008	(b) i pjesërishëm	7. Nxjerrja e Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë afariste; 8. Nxjerrja e Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë profesionale, 9. Nxjerrja e Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë së automjeteve motorike; 10. Nxjerrja e Rregullores për dhënien e lejeve për ndërtim në komuna; 11. Nxjerrja e Rregullores për rregullat e trafikut dhe përcaktimi i gjobave.	

Numri Rendor	Akti Ligjor	Numri i aktit ligjor	Miratimi i aktit ligjor në Kuvendin e Kosovës	Zbatimi i aktit ligjore (a) i plotë (b) i pjesërishëm (c) i pazbatueshëm	Nxjerrja e akteve nënligjorë për zbatimin e drejt dhe efikas të aktit ligjor	Problemet dhe vështirësitë në zbatimin e aktit ligjor
5.	Ligji për Transportin Rrugor	2005/23	23.03.2005	(b) i pjesërishëm	12. Nxjerrja e Rregullores për mënyrën e transportit të udhëtarëve	
6.	Ligji për Ujrat	2004/24	08.07.2004	(b) i pjesërishëm	13. Nxjerrja e vendimit për shpalljen e zonave erozive	Mungesa e resurseve profesionale
7.	Ligji për Planifikimin Hapësinor	2003/14	03.07.2003	(b) i pjesërishëm	14. Përgatitja e planit zhvillimor komunal; 15. Miratimi i Planit Urban Zhvillimor; 16. Miratimi i planit hapësinor	Mungesa e planit hapësinor të përgjithshëm

R e k o m a n d i m e t

Për eliminimin e ngecjes dhe evitimin e mangësive në procesin e zbatimit të Legjislacionit primar, vlerësojmë se Institucionet përgjegjëse në kohën sa më të shkurtër, duhet angazhuar në:

1. Nxjerrja e akteve nënligjore nga komunat në afatin sa më të shkurtër për zbatimin e ligjeve, si dhe përcaktimi i organeve përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe e zbatimin e akteve ligjore primare dhe sekondare;
2. Krijimin dhe vendosjen e një dispozite ligjore, në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të çdo akti ligjor i cili miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës apo akti i cili miratohet nga komuna, e cila do të ketë karakter detyrues për organin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit dhe aktit nënligjor, që të raportoj së paku një herë në vit për procesin e zbatimit të aktit ligjor;
3. Krijimin e një mekanizmi mbikëqyrës unik për zbatimin e Ligjeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe akteve tjera nën ligjore në kuadër të ministrisë dhe komunave, me qëllim të raportimit të vazhdueshëm për shkallën e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore si dhe prezantimin e problemeve dhe vështirësive të zbatimit të ligjeve;
4. Ndërmarrjen e masave përkatëse për funksionalizimin e Divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në kuadër të ministrive dhe zyrtarëve ligjor komunal;
5. Krahas hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar, prioritet i veçantë të jetë edhe procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit.
6. Ndërmarrjen e masave adekuate ndaj të gjithë zyrtarëve përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të cilët me veprimet e tyre ndikojnë në zbatimin jo të drejtë dhe jo të plotë të akteve ligjore dhe nën ligjore.
7. Aftësimin dhe edukimin profesional permanentë të zyrtarëve përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të Legjislacionit primar
8. Transparencën e punës së organeve të cilat merren me mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar në vendin tonë, si dhe
9. Veprime tjera të domosdoshme për avancimin e procesit të zbatimit të plotë dhe efikas të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore të miratuara nga komunat.